

FTESË PËR OFERTË BKT2024SSD014

Blerje ndriçuesish për ambientet e HO - 2

Afati i fundit i dërgimit të ofertave: 09 Gusht 2024, 12:00 p.m

Tiranë, 26/07/2024

Nr. Prot:

Për: Vita Lux

Subjekti: Ftesë për ofertë Ref. BKT2024SSD014

E nderuar Kompani,

BKT për interesa të punës ka zgjeruar infrastukturën e saj, duke shtuar një goninë të re për stafin Drejtorine e Përgjithshme - 2 në Mjull Bathore. Me qëllim përfudimin sa më shpejt të punimeve në godinën e re (referuar në këtë dokument me termin HO- 2), kërkon të blejë ndricues për ambientet e brendëshme. Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj sipas specifikimeve bashkëngjitur. Ne do të bashkëpunojmë me kompaninë që ofron kushtet më të mira për Bankën sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ftesë për ofertë.

Objekti i Ftesës për Ofertë:

Blerje ndriçueshish për ambientet e HO - 2

Përshkrimi Ftesës për Ofertë:

Me qëllim ofrimin e ambienteve sa me dinjitoze për stafin, BKT ka zgjeruar infrastukturën e saj me shtimin e godinës së re të zyrave qendrore (HO-2). Me qëllim përfundimin sa më shpejt të punimeve, BKT ka planifikuar blerjen e ndricuesve për ambientet e HO -2 bazuar në projektin teknik dhe arkitekturor. Bashkëlidhur në ANEKS 1 gjeni listën e plotë të ndricuesve që na nevojiten me sasi specifike teknike dhe imazhe referencë. Imazhet kanë funksion orientues, ndricuesit që do të perzgjidhen jo domosdoshmërisht duhet të jenë identik si në foto. Ndricuesit nuk kërkohet të montohen.

Dokumentacioni:

Oferta duhet të shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe ekonomik. I detyrueshëm është dokumentacioni si më poshtë:

- Ekstrakt historik nga QKB;
- Kopje të NIPT-it;
- Çertifikata e prodhimit ne vendin e origjines;
- Dokumentacion i plotë teknik, manual dhe katalog mbi ndricuesit e ofertuar;
- Garancia dhe lëvrimi.

Oferta ekonomike:

Shoqëria duhet të respektojë formatin e kësaj Ftese për Ofertë në kuotimin e kërkuar. Ju duhet të paraqitni ofertën tuaj sipas specifikimeve të përshkuara në dokumentin teknik bashkangjitur me çmimet përkatëse për punimet/pajisjet të përfshira në ANEKS 1 (të gjitha kostot e parashikuara në këtë ftese për oferte duhet të përfshihen në çmim) e cila duhet të futet në një zarf tjetër brenda zarfit të dokumentave të ofertës. TVSH duhet të jetë e përfshirë në çmim. Çmimet do të jenë fikse dhe të pandryshuara përgjatë gjithë vlefshmërisë së ofertës.

Dorëzimi i ofertës: Oferta juaj, në formatin e kërkuar, në zarf të mbyllur me mbishkrimin e mëposhtëm të vetëm në zarf, të prerë e të ngjitur nga kjo ftesë për ofertë, do të adresohet dhe paraqitet tek:

Në përgjigje të :Ref. BKT2024SSD014

Departamenti i Prokurimeve

Banka Kombëtare Tregtare

Rruga e Vilave, Lunder 1, Drejtoria e Përgjithshme

Tiranë, Shqipëri

Në rast se oferta juaj dorëzohet e hapur, me e-mail, fax ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ajo e kërkuar më lart, oferta nuk do të konsiderohet e vlefshme.

Për çdo pyetje, paqartësi apo vizitë në objekt mund të kontaktoni në adresën e-mail: procurement@bkt.com.al, por jo më vonë se 5 ditë pune nga afati përfundimtar i dorëzimit të ofertave.

Vlefshmëria e Ofertës: Oferta juaj do të jetë e vlefshme për një periudhë të përcaktuar jo më pak se 3 muaj.

Formati i ofertës: Kompania duhet të respektojë formatin e kësaj Ftese për Ofertë në rast të kundërt oferta do të konsiderohet e pavlefshme.

Kontraktuesi është i vetmi përgjegjës për ekzekutimin e kontratës që rezulton nga kjo kërkesë për oferte. Fakti që BKT i lejon kontraktorit të nënkontrakttojë ose të thërrasë një palë të tretë për kryerjen e ndonjë pjese të kontratës, nuk e çliron kontraktorin nga përgjegjësia e tij.











BKT rezervon të drejtën të anulojë procesin e prokurimit, të ndryshojë sasinë ose shërbimet e kërkuara në këtë Kërkesë për Propozim Në këtë proces **nuk** lejohet nënkontraktimi i punimeve ndertimore, elektrike dhe hidraulike.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave në Bankë, në adresën e mësipërme është 09.08 2024, ora 12:00.

Departamenti i Prokurimeve

Aneks 1

Lista e detajuar me çmimet/njësi për çdo artikull

Nr.	Ndricues	Imazh ilustrues	Paraqitja teknike	Njesia	Sasia sipas tipeve (cp)	Sasia sipas kateve (ml)	Cmimi me TVSH
1	Plafon incasso 60x60 (ka ndricues qe do vihen ne strukturten e posacme per ket ndricues, si dhe ndricues qe do inkasohen ne gips te thjesht)			cope	328		
2	Plafon 60x60 jo inkaso			cope	12		
3	Plafon incasso 30x30, antilageshtire			cope	77		
4	Shirit LED incasso 4cm			cope	22	169.15	
				ml			
5	Shirit LED incasso 2cm			cope	24	68.49	
				ml			

6	Shirit LED I harkuar			ml	1	1.5	
7	Shirit LED korridori 4cm Jo incasso			ml	13	32.5	
8	Spot katror incasso			cope	192		
9	Spot rrethor incasso			cope	70		
10	Spot rrethor incasso pikesor			cope	12		
11	Spot cilindrik h=20cm			cope	196		
12	Ndricues i varur linear			cope	15		
13	Ndricues i varur			cope	38		
							
14	Ndricues i varur - reception			cope	2		
15	Mural			cope	20		

***Çmimet e ofertuara duhet të përfshijnë TVSH, transport dhe çdo taksë tjetër të aplikueshme.**

***Çmimet e ofertuara duhet të jenë të pandryshueshme përgjatë gjithë vlefshmërisë së ofertës dhe kontratës.**

***Në ofertë duhet të përfshihet koha e lëvrimit nga porosia.**

*** BKT ka të drejtën e ndryshimeve deri në kontraktimin e kompanisë fituese bazuar në nevojat e saj.**